

SKEDË TEKNIKE

RÖFIX AG 686 MOSAIK

Ngjitës pllakash dhe bojak



Fushat e përdorimit

Llaç shtresë-hollë, një komponent, me ngurtësim fleksibël hidraulik sipas EN 12004 për parapërgatitjen, ngjitjen dhe njëkohësisht stukimin e pllakave mozaik prej xhami ose qeramike të ngjitura në rrjetë dhe letra, mikro-mozaik apo të ngjashme. Karakterizohet nga një punim i lehtë e të lëmuar ashtu dhe një ngjitje shumë të mirë në momentin e kontaktit. Llaç i forcuar rezistent ndaj ndryshimeve ngrirje/shkrirje, si dhe për dyshemetë me sistem ngrohje dhe të përshtatshme nën ujë, si dhe i përshtatshëm për sistemin e termoizolimit RÖFIX StoneEtics.


Karakteristikat

- I patretshëm në ujë
- Rezistent ndaj cikleve ngricëshkrirje
- I qëndrueshëm në formë, rezistent ndaj UV dhe plakjes
- I përshtatshëm për ngrohje dyshemeje
- Kapilaritet i ulët
- Prire e ulët për efloreshencë (kristalizim kripërash)
- Mbi bazamente organike dhe minerale

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	47616	47617
EAN	9003304476169	9003304476176
Paketimi		
Sasi për njësi	15 kg/Nj.	
Njesi per palete	24 Nj./Pal	
Madhësia e kokrrizave	0-0,3 mm	
Ngjyra	gri	
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit.	
Njësia e kërkesës për ujë	ca. 4,3 L/Nj.	
Reaksioni ndaj zjarrit	A2	
Forca në lidhje	≥ 0,8 MPa	
Gati për tu shkëlur	ca. 24 h	

RÖFIX AG 686 MOSAIK

Ngjitës pllakash dhe bojak

Numri i artikullit	47616	47617
Qëndrueshmëria	7 d	
Grupi i ngjitësit për pllaka	Gjerësia 2 EN 12004	
Koha e përpunimit dhe ngjitjes	30 min EN 1346	
Koha e maturimit	5 min	
Koha e hapur	ca. 3 h EN 1015-9	
Temperatura nëntokësore	5-30 °C	
Gati për bojak	direkt pas ngjitjes	

Baza e materialit

- Rërë kuarci (e klasifikuar)
- Aditivë kundërthithës (hidrofobizues)
- Çimento e bardhë
- Aditivë për përmirësimin e vetive të përpunimit

Kushtet e punimit

Deri sa të arrihet tharrja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.

Bazamenti

Të përshtatshme janë, dysheme me bazë çimento- sulfat, çimento, me bazë sulfat-kalciumi dhe betone të vjetra, çimento, gëlqere- çimento, gips, gëlqere, mbi RÖFIX Unistar Light (në sistemin StoneEtics). Të gjitha bazamentet e tjera duhet të korrespondojnë me normat e rregullores. Dyshemetë me bazë sulfat kalciumi duhet të paratrajtohen përpara se të shtrohen me pllaka. Kini parasysh lagështinë e mbetur në varësi të bazamentit. Lagështia e mbetur dysheme (CM):Dysheme çimento 2,0%, dysheme sulfat kalciumi 0,5 %, (dysheme me sistem ngrohje 0,3 %), RÖFIX ZS-dysheme e rrjedhshme 1,8 % (tek pllakat gres format të madh dhe dyshemetë me sistem ngrohje 1,3 %). Tek suvatë (përfshirë RÖFIX Unistar LIGHT) duhet respektuar koha e aplikimit sipas EN 998-1. Betonet duhet të jenë mind. 6 muaj te vjetër sipas (SIA 344,346,348). Tek suvatë me bazë gipsi dhe gips-gëlqere sipas EN 13279-1, duhet patur kujdes kur lagështia e mbetur është mbi 1%. Bazamenti duhet të jetë i i qëndrueshëm me aftësi mbajtëse, i pastër, pa plasartije, pa

mbetje vajrash, pa lyerje të vjetra dhe mjaftueshmërisht i thatë.

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Për bazamente me aftësi thithëse përdorni astarin RÖFIX AP 300, ndërsa për bazamente kritike shumicën e rasteve ne sugjerojmë fortësuesin RÖFIX AP 320. Parregullsitë e vogla dhe vrimat në sipërfaqe duhet të riparohen me llaçin special RÖFIX FS 630:

Përgatitja

Përziejini në mënyrë homogjene me një përzierës mekanik, duke rregulluar mundësisht konsistencën duke shtuar një sasi të vogël uji. Pasi përziejmë e lemë të pushojë dhe më pas e përziejmë përsëri.

Përpunimi

Shtrojeni llaçin shtrat hollë RÖFIX me anën e lëmuar të shpatullës të përshtatshme dhe me anën e dhëmbëzuar vijëzoheni dhe përhapeni mundësisht vetëm në një drejtim.Pllakat prej mozaiku të ngjitura në pjesën e përparme, vendosini në shtratin e ngjitësit dhe me anën e një shpatulluesi prej gome ushtroni presion njëtrajtësisht, duke siguruar ngjitjen e barabartë në të gjithë sipërfaqen. Sigurohuni që distanca midis pllakave të mozaikut gjithmonë ti përgjigjet gjerësisë së fugave të pllakave mozaik, në mënyrë që të gjitha fuga të jenë të gjëra njësoj. Në intervale të rregullta kohe, në varësi të sipërfaqes me pllakë, me një

ROFIX AG 686 MOSAIK

Ngjitës pllakash dhe bojak

sfungjer të lagur hiqet letra nga pllakat prej mozaiku derisa të shkëputet nga gurët e mozaikut.

Sipërfaqja prej mozaiku lahet me një sfyngjer të pastër diagonalisht deri tek rrjeta e fugës. Kujdes mos lani fugat e sapo mbushura. Pllakat e mozaikut ngjitur në rrjetë në pjesën e prapme vendosen direkt tek ngjitësi duke ushtruar presion me anën e një sfyngjeri të lagësht. Sigurohuni që fugat të mos lahen.

Ashtu si me pllaka mozaik të ngjitur në letër mbështetëse, vëmendja duhet t'i kushtohet edhe pllakave mozaik të lidhura me rrjetën që bën ndarjen uniforme të fugave. Nëse është e nevojshme, mund të bëhet dhe njëherë fugimi me ROFIX AG 686 MOSAIK ngjitës dhe bojak për pllaka mozaik. Pasi bëhet fugimi mund të pastroni me një sfyngjer të lagur nga sipërfaqja të gjitha papastërtitë.

Mos shtroni më shumë ngjitës sesa mund të shtroni pllaka. Materialin e vjetër mos e përzieni me materialin e ri, të freskët.

Mistri me dhëmbëza për ngjitës shtresë hollë

Nëse koha e shtrimit tejkalohet, shtroni një shtresë të re, të hollë me ngjitës duke përdorur një shpatull të dhëmbëzuar. Në këtë mënyrë shkatërrohet ndërkohë dhe cipa e mpiksur.

Këshilla në rast reziku

Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.

Magaznimi

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit min. 24 muaj sipas rregullores 1907/2006/EG aneksi XVII në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambjenti.

Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.